



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2555 Dt 13.11.2023

Në bazë të nenit 26 dhe 29 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë dhe në bazë të autorizimit të Senatit të datës 13.11.2023 për ndryshimin e kalendarit akademik, rektorja e UIBM-së mori:

VENDIM

për shtyerje të afatit për vendosjen e notave dhe regjistrim të semestrit

- I. Shtyhet afati i tetorit 2022/23 për vendosje të notave.
- II. Shtyhet afati i tetorit 2023/24 për regjistrim të semestrit dimëror.
- III. Afati për vendosje të notave përcaktohet të jetë deri më 16.11.2023.
- IV. Afati për regjistrim të semestrit dimëror përcaktohet të jetë deri më 22.11.2023.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Më 07 nëntor 2023, UIBM ka pranuar njoftim nga kompania për mirëmbajtjen e Sistemit për Menaxhimin Universitar "UNISOFT", se ky sistem nuk është funksional për shkak të sulmeve kibernetike që janë drejtuar në nën-domenin SMU.UIBM. Të njëjtit gjithashtu kanë njoftuar se janë duke kryer disa konfigurime të nevojshme në qendër të të dhënave.

Me datë 31.10.2023 kemi pranuar njoftimin dhe kërkesën nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike si dhe, me datë 08.11.2023 nga Parlamenti i Studentëve për rihapjen e SMU-së për regjistrimin e semestrit për shkak se sistemi nuk ka punuar.

Andaj, mbështetur në këto kërkesa, për shkak të kësaj situate të jashtëzakonshme, si rezultat i mosfunksionimit të SMU-së për shkak të sulmeve kibernetike, rektorja e UIBM vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Personelit të UIBM-së,
2. Arkivit të UIBM-së.

Prof. asoc. dr. Merita Shala

Rektore e UIBM-së

